

RBI: 804 milionë euro fitim i konsoliduar pavarësisht efekteve për shkak të pandemisë së COVID-19

Pavarësisht kushteve tejet sfiduese të tregut dhe kësaj situatë të vazhdueshme me norma të ulëta interesi, Raiffeisen Bank International (RBI) regjistroi një fitim të konsoliduar prej 804 milionë euro. Përveç efekteve të saj të drejtpërdrejta, pandemia shkaktoi po ashtu një rënie të konsiderueshme të normës së interesit dhe zhvlerësime të monedhës në disa nga tregjet kryesore të RBI-së.

"Pandemia e gjeti RBI-në një pozicion të fuqishëm dhe kjo ishte arsyeja pse RBI shënoi një rezultat të kënaqshëm, duke marrë parasysh mjedisin shumë të vështirë", u shpreh Johann Strobl, CEO i RBI.

Duke marrë në konsideratë rekomandimin e BQE-së lidhur me pagesat e dividendit, Bordi Drejtues i RBI-së ka planifikuar t'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme Vjetore, e cila pritet të zhvillohet më 22 prill 2021, të paguajë një dividend prej 0,48 euro për aksion.

"Niveli ynë i kapitalizimit është i mirë, gjë që na lejon të rritemi me klientët tanë dhe njëkohësisht të lejojmë aksionarët tanë të marrin pjesë në suksesin e RBI-së," tha Strobl.

Falë progresit të vaksinimeve ndaj COVID-19, pritet të kemi një lehtësim të kufizimeve pjesërisht rigorozë për tremujorin e dytë të 2021. E kombinuar me këtë kërkesë kaq të fuqishme, si dhe stimujt e politikës monetare dhe fiskale, kjo pritet të gjenerojë një rimëkëmbje të konsiderueshme ekonomike gjatë vitit. Pas një zhvillimi negativ të PBB-së në të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore në vitin 2020, për vitin 2021 Raiffeisen Research rrjedhimisht pret një rritje të PBB-së prej 3,7 përqind në Evropën Qendrore, 4,6 përqind në Evropën Juglindore, 2,4 përqind në Evropën Lindore dhe 3,5 përqind në Austri.

Shpenzimet e përgjithshme administrative kanë shënuar rënie

Të ardhurat operative shënuan rënie me 5 përqind në vlerën 5195 milionë euro, ndikuar veçanërisht nga një rënie prej 5 përqind në të ardhurat neto nga interesi (3241 milionë euro) dhe një rënie prej 3 përqind në të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet (1738 milionë euro). Masat e izolimit kombëtar sollën rënie të të ardhurave, veçanërisht gjatë tremujorit të dytë, ndërsa të ardhurat neto nga interesi u ndikuan nga normat më të ulëta të interesit, kryesisht si rezultat i uljeve të normave bazë të interesit në disa tregje. Kjo u kompensua me një ulje të shpenzimeve të përgjithshme administrative, po me 5 përqind, në vlerën 2949 milionë euro. Faktorët kryesorë që ndikuan ishin reduktimi i shpenzimeve të tjera administrative dhe efekteve të monedhës. Me 56,8 përqind, raporti kosto/të ardhura shënoi 0,3 pikë përqindje më i lartë se në vitin e kaluar.

Humbjet nga zhvlerësimi nga aktivet financiare janë rritur për shkak të recesionit

Recesioni i shkaktuar nga COVID-19 pati një ndikim negativ në RBI kryesisht përmes humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve financiare në shumën prej 630 milionë euro, nga të cilat 288 milionë euro i atribuohen fazës 3, d.m.th. janë klasifikuar si të humbura.

Në vlerën 1,9 përqind, raporti i NPE ishte 0,2 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë, kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të kredive, pasi kreditë me probleme mbetën pothuajse në nivele të qëndrueshme për shkak të shitjeve dhe mosnjohjes së tyre. Raporti i mbulimit të NPE u rrit me 0,5 pikë përqindje, në 61,5 përqind.

Raporti i përgjithshëm i kapitalit (i ngarkuar plotë) shënoi 18,4 për qind

Në vitin 2020, raporti i CET 1 (i ngarkuar i plotë) ishte 13,6 për qind. Dividenti i propozuar fillimisht për vitin 2019 mbetet i zbritur, ashtu si edhe propozimi për dividendin për vitin 2020. Raporti i nivelit 1 qëndroi në 15,7 për qind dhe raporti i përgjithshëm i kapitalit shënoi 18,4 për qind.

Përmbledhje

Presim të ketë një rritje modeste të huadhënies në gjashtëmuorin e parë të 2021, e cila pritet të përshpejtohet në gjysmën e dytë të vitit.

Raporti i provigjionimit për Vitin Financiar 2021 pritet të jetë rreth 75 pikë bazë, për shkak të përfundimit të moratoriumit dhe programeve mbështetëse të qeverisë.

Ne do të mbetemi të angazhuar ndaj një raporti kosto/të ardhura prej rreth 55 përqind - , e me shumë gjasa deri në vitin 2022 në varësi të ecurisë së rimëkëmbjes.

Pritet që kthimi i konsoliduar mbi kapitalin të përmirësohet në 2021, duke synuar 11 përqind në terma afatmesme.

Konfirmojmë objektivin tonë që raporti i CET1 të jetë rreth 13 përqind për një periudhë afatmesme.

Bazuar në këtë objektivi, ne synojmë të shpërndajmë nga 20 deri në 50 përqind të fitimit të konsoliduar.

* * * * *

Raporti Vjetor është i disponueshëm në adresën <http://ar2020.rbinternational.com>, ndërsa versioni në gjermanisht është i disponueshëm në adresën <http://gb2020.rbinternational.com>.

Raporti i Qëndrueshmërisë së RBI-së u publikua sot njëkohësisht me Raportin Vjetor. Këtë raport të konsoliduar jofinanciar, i cili është në përputhje me Ligjin Austriak të Qëndrueshmërisë dhe Përmirësimit të Diversitetit (Nachhaltigkeits- und Diversitätsverbesserungsgesetz) me parimin udhëzues "Bankingu i përgjegjshëm për një të ardhme të qëndrueshme" mund ta gjeni në adresën www.rbinternational.com/sustainabilityreport.

Përmbledhje - Raiffeisen Bank International (RBI)

Vlerat monetare të shprehura në milionë €	2020	2019	Ndryshimi	2018	2017	2016
Pasqyra e të Ardhurave	1/1-31/12	1/1-31/12		1/1-31/12	1/1-31/12	1/1-31/12
Të ardhura Neto nga Interesat	3.241	3.412	(5,0)%	3.362	3.225	2.935
Të ardhurat neto nga tarifaf dhe komisionet	1.738	1.797	(3,3)%	1.791	1.719	1.497
Shpenzime të përgjithshme administrative	(2949)	(3.093)	(4,7)%	(3.048)	(3.011)	(2.848)
Rezultate operative	2.246	2.382	(5,7)%	2.330	2.164	1.844
Humbjet nga zhvlerësimi nga aktivet financiare	(630)	(234)	169,1%	(166)	(312)	(754)
Fitimi/humbja para taksave	1.233	1.767	(30,2)%	1.753	1.612	886
Fitimi/humbja pas taksave	910	1.365	(33,3)%	1.398	1.246	574
Fitimi/humbja e konsoliduar	804	1.227	(34,5)%	1.270	1.116	463
Pasqyra e pozicionit financiar	31/12	31/12		31/12	31/12	31/12
Kredi ndaj bankave	11.952	9.435	26,7%	9.998	10.741	9.900
Kredi ndaj konsumatorëve	90.671	91.204	(0,6)%	80.866	77.745	70.514
Depozita nga bankat	29.121	23.607	23,4%	23.980	22.378	12.816
Depozita nga klientët	102.112	96.214	6,1%	87.038	84.974	71.538
Kapitali	14.288	13.765	3,8%	12.413	11.241	9.232
Totali i aktiveve	165.959	152.200	9,0%	140.115	135.146	111.864
Raportet kyçe	1/1-31/12	1/1-31/12		1/1-31/12	1/1-31/12	1/1-31/12
Kthim mbi kapitalin para taksave	9,2%	14,2%	(5.0) PP	16,3%	16,2%	10,3%
Kthim mbi kapitalin pas taksave	6,8%	11,0%	(4.2) PP	12,7%	12,5%	6,7%
Kthimi i konsoliduar mbi kapitalin	6,4%	11,0%	(4.5) PP	12,6%	12,2%	5,8%
Raporti kosto/të ardhura	56,8%	56,5%	0.3 PP	56,7%	58,2%	60,7%
Kthim mbi asetet para taksave	0,77%	1,18%	(0.42) PP	1,33%	1,23%	0,79%
Marzhi i interesit neto (mesatarja e asetëve me interes)	2,15%	2,44%	(0.29) PP	2,50%	2,48%	2,78%
Raporti i huadhënies (mesatarja e kredive ndaj konsumatorëve)	0,68%	0,26%	0.42 PP	0,21%	0,41%	1,05%
Informacion specifik për bankat	31/12	31/12		31/12	31/12	31/12
Raporti i ekspozimeve të këqija (NPE) (%)	1,9%	2,1%	(0.2) PP	2,6%	4,0%	-
Raporti i mbulimit të NPE (%)	61,5%	61,0%	0.5 PP	58,3%	56,1%	-
Totali i asetëve të ponderuara ndaj riskut (RWA)	78.864	77.966	1,2%	72.672	71.902	60.061
Raporti i kapitalit të përbashkët të nivelit 1 (i ngarkuar i plotë)	13,6%	13,9%	(0.3) PP	13,4%	12,7%	13,6%
Raporti i nivelit 2 (i ngarkuar i plotë)	15,7%	15,4%	0.3 PP	14,9%	13,6%	13,6%
Totali i raportit të kapitalit (i ngarkuar i plotë)	18,4%	17,9%	0.5 PP	18,2%	17,8%	18,9%
Të dhëna për stokun	1/1-31/12	1/1-31/12		1/1-31/12	1/1-31/12	1/1-31/12
Fitimi për aksion në €	2,22	3,54	(37,4)%	3,68	3,34	1,58
Çmimi i mbylljes në € (31/12)	16,68	22,39	(25,5)%	22,20	30,20	17,38
I lartë (çmimet e mbylljes) në €	22,92	24,31	(5,7)%	35,32	30,72	18,29
I ulët (çmimet e mbylljes) në €	11,25	18,69	(39,8)%	21,30	17,67	10,21
Numri i aksioneve në milionë (31/12)	328,94	328,94	0,0%	328,94	328,94	292,98
Kapitalizimi i tregut në milionë € (31/12)	5.487	7.365	(25,5)%	7.302	9.934	5.092
Dividendi për aksion në €	0,48	-	-	0,93	0,62	-
Burimet	31/12	31/12		31/12	31/12	31/12
Të punësuarit në datën e raportimit (me kohë të plotë ose të barsvlershme)	45.414	46.873	(3,1)%	47.079	49.700	48.556
Pikat e biznesit	1.857	2.040	(9,0)%	2.159	2.409	2.506
Klientë në milionë	17,2	16,7	2,5%	16,1	16,5	14,1

Në këtë raport, Raiffeisen Bank International (RBI) i referohet Grupit RBI. RBI AG përdoret sa herë që pasqyrat i referohen vetëm Raiffeisen Bank International AG. Selia kryesore i referohet Raiffeisen Bank International AG, duke përfshirë degët. Që nga janari 2017, biznesi si kontribut i Raiffeisen Zentralbank AG është përfshirë plotësisht.

Për shkak të miratimit të SNRF në vitin 2018, shifrat për periudhat e mëparshme janë të krahasueshme deri në një shkallë të caktuar.

RBI i referohet Austrisë, ku është një bankë lider për korporata dhe investime, si dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore (EQL) si treg mëmë. 13 tregje në këtë rajon mbulohen nga filialet e bankës. Për më tepër, Grupi RBI përfshin edhe ofrues të tjerë të shumtë të shërbimeve financiare, për shembull për qiratë financiare (leasing), menaxhimin e aseteve ose Bashkime & Blerje (M&A).

Rreth 45,000 punonjës u shërbejnë 17.2 milionë klientëve në përafërsisht 1,900 degë, duke mbuluar kështu pjesën më të madhe të territorit të EQL. Aksionet e RBI janë të listuara në Bursën e Vienës. Bankat Rajonale Austriake Raiffeisen zotërojnë rreth 58,8 përqind të aksioneve, ndërsa pjesa tjetër operojnë të pavarura. Brenda Grupit Bankar Raiffeisen në Austri, RBI është instituti qendror i Bankave Rajonale Raiffeisen dhe institucioneve të tjera të lidhura të kreditit.

Për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni:

Ingrid Krenn-Ditz (+43-1-71 707-6055, ingrid.krenn-ditz@rbinternational.com) ose

Christof Danz (+43-1-71 707-1930, christof.danz@rbinternational.com)

www.rbinternational.com